



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:239756

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05231914

AA.nr.151/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Hajriz Hoti dhe Mehmet Ndrecaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit paditësit B... Th..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A... K..., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Mirëqenies Sociale, me bazë juridike “kompensim dëmi”, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.2649/2022, të datës 15.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit B... Th... nga fshati S..., Komuna e Obiliqit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2649/2022, i datës 15.02.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin, A.nr.2649/2022, të datës 15.02.2023, e ka hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësit B... Th..., me nën shenjën A. nr.2649/2022.

Kundër këtij aktvendimit në afatin ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat A... K..., nga Prishtina për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative respektivisht të Ligjit për Konfliktin Administrativ, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta prishë dhe lenden ta kthejë në kompetence lëndore të Departamentit të Përgjithshëm Civil apo në Departamentin për Çështje Administrative.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B... Th... nga fshati S..., Komuna e Obiliqit, me datë 25.10.2016, ka ushtruar padi fillimisht pranë Departamentit të Përgjithshëm/ Divizioni Civil në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Mirëqenies Sociale, në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura ti kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 990,00 euro.

Duke qenë se Divizioni Civil i gjykatës ishte shpallur jokompetent dhe çështja kishte kaluar në Departamentin Administrativ, gjyqtarja e rastit kishte bërë shqyrtimin paraprak të padisë dhe kishte vërejtur se padia e paditësit ka të meta, ngase me të njëjtën nuk kontestohet asnjë akt administrativ, dhe në anën tjetër nga paditësi nuk u dëshmuar se kishte shterur mjetet juridike në procedurë administrative pranë organeve administrative. Kështu me qëllim të evitimit të të metave si më lartë gjykata e shkallës së parë, me vendimin A.nr.2649/22 të datës 03.02.2022, e kishte obliguar përfaqësuesin e paditësit që ti bëjë të ditur gjykatës se cilin vendim përfundimtar të të paditurës e konteston me padi ose të dëshmoj se konfliktin administrativ e ka inicuar mbi bazën e heshtjes administrative. Mirëpo edhe përkundër kësaj paditësi në parashtrësën “Parashtrësë për precizimin e padisë “ të dorëzuar në gjykatë me datë 14.02.2023, nuk kishte vepruar në zbatim të vendimit të gjykatës mirëpo i njëjti vetëm se kishte theksuar: *në këtë çështje kontestimore padia e parashtruar ka të bëjë me kompensimin e dëmit material të shkaktuar nga e paditura e cila në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore – Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm A.nr.1497/12 është anuluar vendimi i të paditurës si i kundërligjshëm mirëpo palës paditëse nuk i është bërë kompensimi i ndihmës sociale.*

Kështu për të vlerësuar lejueshmërinë e padisë së paditësit edhe pas këtij “precizimi të padisë”, i cili bënë të ditur se lidhur me çështjen e tij ishte nxjerr nga Departamenti për Çështje Administrative aktgjykimi A. nr.1497/12, përmes të cilit kuptohet se nuk ishte vendosur meritorisht lidhur me çështjen e paditësit ngase ishte anuluar vendimi i të paditurës por nuk ishte vendosur për çështjen e kompensimit të dëmit pasi çështja ishte kthyer në rivendosje të e paditura, gjykata e shkallës së parë i’u referua Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), nenit 68 paragrafi 1, ku është përcaktuar: *“Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin.* Prandaj duke pasur parasysh se paditësi nuk dëshmoi me prova se ka kërkuar nga e paditura të veprojnë në zbatim të aktgjykimit A.nr.1497/12 dhe në rast se e njëjta nuk vepron ti ketë kërkuar më pas gjykatës nxjerrjen e aktit, gjykata e shkallës së parë vlerëson se ndaj objektit të kërkesëpadisë së paditësit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit. Andaj mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 34.1.1.5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padinë e paditësit e hedhë si të palejueshme, si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Sepse me dispozitën e nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”. Ndërsa me nenin 10 par.1 të të njëjtit Ligj, është përcaktuar se “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”. Kurse me dispozitën e nenit 15 par.1 pika 1.2 të të njëjtit Ligj, i cili rregullon rastet se kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, përcaktohet se “1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”. Pastaj edhe sipas nenit 29, paragrafit 1, përcaktohet: “1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa”. Me pas, me dispozitën ligjore nga neni 34 par.1 pika 1.5 të të njëjtit ligj përcaktohet “1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”.

Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë e ka hedhë poshtë padinë e paditësit në këtë çështje juridiko-administrative si të palejuar, meqë paditësi nuk ka arritur që të bëjë të qartë kërkesën e tij për anulimin e ndonjë akti administrativ përfundimtar apo nxjerrjen e ndonjë akti administrativ në rast të heshtjes së administratës.

Në rastin konkret duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se padia e paditësit është e palejueshme, ngase në këtë çështje juridike nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ, meqë paditësi siç u theksua më lartë nuk ka arritur të bëjë të qartë kërkesën e tij që do të aludonte në anulimin e ndonjë akti administrativ përfundimtar në procedurën administrative. Andaj, në situatën konkrete pretendimet ankimore të paditësit se në rastin konkret është dashtë gjykata të vendos në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit. Pastaj se në këtë çështje kontestimore civile –juridike, mendoj se e kompetencës lëndore duhet të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe se gjykata sipas detyrës zyrtare është dashtë ta adresoj çështjen e vendosjes. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore vlerëson se janë të pa bazuara për vendosje ndryshe të kësaj çështje juridike. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, për faktin se aktvendimi është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale të parapara me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe neni 63 të LKA-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:239756
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05231914

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.151/2023, me datë 16.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi